

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KUVENDI KOMUNAL VITI

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	657-25-1468-1-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: "Furnizim për Bletari; Fletë dylli dhe Koshere tre katëshe".

ANKESË

N.T.P "Bletaria Egzoni"

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Gjakovë, Minatori

(Adresa)

Gjakovë

50 000

(Vendi)

(Kodi postar)

044-442-930

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Egëzon Agushi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

bletaria_egzoni@hotmail.com

(Adresa elektronike)

22.05.2025

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 03.03.2025

Hapja e ofertave: 01.04.2025

Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 02.05.2025

Kërkesa për rishqyrtim: 07.05.2025

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim i dt.15.05.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 61 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftimi për Kontratë është bërë me dt. 03.03.2025, kurse hapja e ofertave është bërë me dt. 01.04.2025, ku kanë qenë 4 ofertues .
Njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar me dt. 02.05.2025 ku është rekomanduar për kontratë OE **Bletaria Te Ahmeti SH.P.K.**, kurse neve na është dërguar letra standarde për tenderues të pasuksesshëm.

Ne kemi kërkuar qasje në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë dhe OE të tjerë dhe në dokumentet tjera të këtij aktiviteti të prokurimit, ku dje me dt.06.05.2025, na është lejuar qasja në dokumente.

Pas analizës që i kemi bërë dokumenteve të OE të rekomanduar për kontratë kemi ardh në përfundim që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

Fillimisht ju sqarojmë se ne me dt.19.03.2025 kemi parashtruar kërkesën për sqarime para hapjes së ofertave, ndërsa AK-ja na ka kthyer përgjigje me dt.24.03.2025.

Në lidhje me specifikat teknike ne kemi parashtruar pyetjen si në vijim:

Nëse kërkohet fletë dylli 100% natyral duhet të kërkohet Certifikatat ISO 22000:2018, Për sistemin e menaxhimit të sigurisë ushqimore. Certifikatat duhet të jene VALIDE të noterizuara nga vendi i prodhuesit.

Në lidhje me pyetjen e lartcekur AK-ja ka dhënë përgjigjen si në vijim:

Me qenë se kërkohet -Fletë dylli 100% natyral pa shtesa tjera-duhet të argumentohet që produkti është 100% natyral.

Siç është edhe e specifikuar me LPP, sqarimet të cilat bëhen para datës së hapjes së ofertave, bëhen automatikisht pjesë e dosjes së tenderit.

Gjatë analizës së dokumenteve të OE të rekomanduar për kontratë ne nuk kemi hasur në ndonjë dokument përmes të cilit argumentohet që produkti-dylli është 100%.

Përderisa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar një dokument të tillë, atëherë kuptohet qartë se i njëjti OE është dashur të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Kur vet AK-ja e ka sqaruar qartë se duhet të argumentohet me dëshmi se produkti është 100% natyral dhe OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka prezantuar një dokument të tillë, atëherë i njëjti është dashur të eliminohet nga ana e AK-së dhe jo të rekomandohet për kontratë edhe përkundër faktit që ky OE është i papërgjegjshëm.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti ka ofertuar me çmim jo normalisht të ulët për pozicionin 1-Fletë dylli, Fletë dylli 100% natyral pa shtojca tjera. Çmimi me të cilin ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë është çmim shumë i ulët në krahasim me çmimet e tregut për dyllin 100% natyral.

OE i rekomanduar për kontratë përderisa nuk ka prezantuar ndonjë dëshmi që posedon dyll 100% natyral pa shtojca tjera, atëherë kuptohet qartë se çmimi i dhënë nga i njëjti nuk është për produktin 100% natyral, pra nuk është për produktin i cili çmimin në treg e ka shumë më të lartë se sa çmimi me të cilin ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë.

Sa për sqarim ne në ofertën tonë kemi dorëzuar raportin e analizave të dyllit nga prodhuesi e i cili e argumenton që dylli është 100% pa shtesa tjera. Andaj në këtë rast po favorizohen kompani të caktuara të cilat nuk kanë ofertuar konform specifikave teknik, ndërsa po favorizohet OE i rekomanduar për kontratë.

Gjithashtu edhe OE **"BAJRA "**, me çmim më të lirë se sa ne, i cili është cilësuar si OE i pasuksesshëm nga ana e AK-së, i njëjti pas analizës së dokumentacionit që i kemi bërë është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

Gjatë analizës së dokumenteve të OE të lartcekur ne nuk kemi hasur në ndonjë dokument përmes të cilit argumentohet që produkti-dylli është 100%.

Përderisa OE i lartcekur nuk ka prezantuar një dokument të tillë, atëherë kuptohet qartë se i njëjti OE është dashur të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të cilësohet si i pasuksesshëm.

Kur vet AK-ja përmes përgjigjeve të saj në sqarimet e kërkuara nga ne, e ka sqaruar qartë se duhet të argumentohet me dëshmi se produkti është 100% natyral dhe OE i lartcekur nuk e ka prezantuar një dokument të tillë, atëherë i njëjti është dashur të eliminohet nga ana e AK-së dhe jo të cilësohet si OE i pasuksesshëm.

Ne pajtohemi me arsyet e eliminimit të AK-së për OE **"AG-FERM SH.P.K "**, i cili është cilësuar është eliminuar me arsyetimin se nuk ka dorëzuar specifikat teknike.

I njëjti OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se edhe ky OE nuk ka dorëzuar dëshmi dokumentare përmes të cilës vërtetohet fakti që dylli është 100% origjinale pa shtesa tjera.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë e lartcekura, kuptohet qartë se OE i rekomanduar dhe OE të tjerë janë të papërgjegjshëm dhe si të tillë është dashur të eliminohen nga aktiviteti i prokurimit, ndërsa vetëm ne jemi OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit, prandaj edhe është dashur të rekomandohemi për kontratë.

Ne me dt.15.05.2025 kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, mirëpo që AK-ja nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret në lidhje me një refuzim të tillë, pasi që arsyetimi nuk ka asnjë bazë ligjore.

Autoriteti kontraktues në vendimin e saj për refuzim të kërkesës për rishqyrtim të gjithë arsyetimin e saj e bazuar në atë se kinse përgjigjja e AK-së në sqarimet e dhëna nuk ka qenë kërkesë kualifikuese, mirëpo vetëm një pasues. Njëkohësisht AK-ja e ka cekur se OE kanë pranuar si obligim zbatimin e kushteve në SDT të jenë pjesë e kontratës dhe se ato do të jenë specifikime mbi standardin e produktit, siç është në këtë rast kushti që të sjellin dëshmi të verifikueshme mbi cilësinë gjegjësisht kualitetin e produktit origjinal.

Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se të gjitha sqarimet të cilat bëhen para datës së dorëzimit të ofertave, të njëjtat bëhen pjesë e dosjes së tenderit, andaj në këtë rast nuk mund të thuhet se një pasues nga specifikat teknike të detyrueshme nuk është kriter kualifikues.

Vet autoriteti kontraktues po bie në kundërshtim me përgjigjet e saj të cilat i ka dhënë gjatë fazës para ofertimit, pasi që tani përgjigjet e saj nuk po i respekton me qëllimin e vetëm favorizimin e OE të rekomanduar për kontratë. Çdo specifikë teknike është kriter i cili duhet të respektohet në fazën para dorëzimit të ofertave, andaj edhe në këtë rast OE i rekomanduar për kontratë dhe OE të tjerë janë të papërgjegjshëm sepse nuk kanë ofertuar konform specifikave teknike.

Siç edhe e kemi cekur më lartë OE të cilët nuk kanë prezantuar ndonjë dokument përmes të cilit argumentohet që produkti-dylli është 100%, të njëjtit mund të prezantojnë dyllin jo 100% siç është kërkuar dhe për këtë fakt edhe janë ofertues me çmim më të lirë.

Arsyetimi i AK-së se raporti i analizave mbi vërtetësinë siç pretendon ankuesi duhet të sillet bashkë me mallin dhe këtë e bën komisioni i pranimit, por kurrësi komisioni i vlerësimit të tenderëve, sepse nuk ka qenë kërkesë kualifikuese, është arsyetim absurd. Ky arsyetim është i paqëndrueshëm për faktin se analiza mbi vërtetësinë e 100% të dyllit, nuk mund dhe nuk duhet që në asnjë mënyrë të kërkohej vetëm në momentin e furnizimit, mirëpo duhet të kërkohej edhe në momentin e dorëzimit të ofertave, ashtu siç e ka cekur edhe AK-ja në sqarime se duhet të prezantohet-argumentohet se fleta e dyllit është 100% natyral.

Përderisa në përgjigjet e AK-së është kërkuar që të argumentohet se produkti fletë dylli është 100% natyral pa shtesa tjera, atëherë nuk mund të thuhet në asnjë mënyrë që raportet e analizave apo ndonjë dokument tjetër do të kërkohej në fazën para furnizimit, mirëpo një dokument i tillë duhet të ofrohet me rastin e dorëzimit të ofertës.

Autoriteti kontraktues në arsyetimin e saj nuk ka dhënë asnjë përgjigje në lidhje me çmimet me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë, e për të cilat çmime ne kemi parashtruar pretendimet tona ankimore se të njëjtat janë jo çmime normalisht të ulëta. Përderisa AK-ja nuk e ka arsyetuar në asnjë mënyrë të kundërtën e pretendimeve tona ankimore sa i përket çmimeve me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë, atëherë kuptohet qartë se pretendimi ynë është i bazuar, sepse në të kundërtën AK-ja do ta kishte argumentuar të kundërtën e pretendimit tonë ankimor me fakte dhe dëshmi konkrete.

Autoriteti kontraktues në pretendimet tjera ankimore kundrejt OE BAJRA, nuk i ka shqyrtuar fare, mirëpo vetëm e ka cekur se i njëjti është i përgjegjshëm, pa dhënë ndonjë dëshmi apo fakt konkret në lidhje me arsyetimin e saj.

AK-ja është arsyetuar se kinse është kërkuar vetëm të bëhet nënshkrimi dhe vulosja e aneksit 1 dhe jo të ofrohen dëshmi tjera, mirëpo ky arsyetim i të njëjtës është në kundërshtim me përgjigjen të cilën e ka dhënë AK-ja para datës së hapjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i paqëndrueshëm dhe njëkohësisht i pa mbështetur në dispozita ligjore, andaj si i tillë nuk mund dhe nuk duhet të merret parasysh një refuzim i tillë nga ana e OSHP-së.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, **e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse ne jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parashih qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*.

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parashih që *“Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse”*, kurse OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Gjatë zhvillimit të kësaj procedure nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga ju si OSHP që të nxjerrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE N.T.P “Bletaria Egzoni”

ANULOHET njoftimi mbi vendimin (B58) e AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, ankesës në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.